**VENDIM**
**Nr. 40, datë 30.9.2013**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Vladimir Kristo | anëtar i Gjykatës Kushtetuese, drejtues i seancës | | |
| Sokol Berberi | anëtar i | “ | “ |
| Vitore Tusha | anëtare e | “ | “ |
| Fatmir Hoxha | anëtar i | “ | “ |
| Gani Dizdari | anëtar i | “ | “ |
| Besnik Imeraj | anëtar i | “ | “ |
| Fatos Lulo | anëtar i | “ | “ |
| Altina Xhoxhaj | anëtare e | “ | “ |

me sekretare Blerina Basha, në datën 13.6.2013 mori në shqyrtim në seancë plenare me dyer të hapura çështjen nr. 16 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Minerva Kotherja, përfaqësuar nga Endri Kotherja, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Ministria e Drejtësisë, të përfaqësuara nga Avokati i Shtetit, Armer Juka, me autorizim.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit, brenda afatit të arsyeshëm, të vendimit nr. 1340, datë 24.2.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17/2, 41, 42/1, 44, 118/1, 131/f, 134/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, 13, neni 1 i protokollit nr. 1 dhe protokolli nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, pretendimet e përfaqësuesit të kërkueses, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, parashtrimet e përfaqësuesit të subjekteve të interesuara, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës, dhe pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja Minerva Kotherja është njëra prej trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënësit Shefikat Bylykbashi, i cili, me vendimin nr. 373/2, datë 27.7.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Elbasan, është njohur pronar për pasurinë prej 2 490 $m^2$ truall dhe është vendosur kompensimi në vlerë për këtë sipërfaqe, pasi është konsideruar truall i zënë.

2. Me kërkesën e datës 12.1.2009, kërkuesja i është drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) Tiranë, për përfitimin e kompensimit financiar, për sipërfaqen e truallit prej 2 490 $m^2$.

3. Me shkresën nr. 67/1 prot., datë 16.1.2009, AKKP-ja i ka kthyer përgjigje kërkueses se duhej të paraqitej pranë këtij institucioni pas njoftimit të datës për aplikim, pasi afati për paraqitjen e kërkesave kishte filluar në datën 3.11.2008 dhe kishte përfunduar në datën 3.12.2008.

4. Kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi, me objekt “*Detyrimi i të paditurit, AKKP-ja Tiranë të nxjerrë aktin përkatës administrativ për realizimin e të drejtës së kompensimit në vlerë në favor të Shefikat Bylykbashit (trashëgimtarëve), si pronar i tokës truall në qytetin e Elbasanit.*”

5. Me vendimin nr. 1340, datë 24.2.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: “*Pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e të paditurit, AKKP-ja Tiranë, të nxjerrë aktin administrativ*

*lidhur me kërkesën e paditëses Minerva Kotherja për kompensimin në vlerë të pronës.*"

6. Me vendimin nr. 2172, datë 25.10.2011, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të gjykatës së shkallës së parë.

7. Me kërkesën e datës 25.9.2012, kërkuesja i është drejtuar AKKP-së për ekzekutimin vullnetar të detyrimit që rrjedh nga vendimet gjyqësore.

8. Me kërkesën e datës 24.10.2012, kërkuesja i është drejtuar Ministrit të Drejtësisë, në mënyrë që ky i fundit të ushtrojë kompetencat ligjore, të parashikuara në ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës, për ekzekutimin e detyrimit nga ana e AKKP-së.

9. Me shkresën nr. 2672/1 prot., datë 7.12.2012, Ministria e Drejtësisë i është drejtuar AKKP-së, duke i kërkuar marrjen e masave për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, pasi veprime të tilla sjellin zvarritje të procesit të kompensimit.

10. Me shkresën nr. 4101/1 prot., datë 27.12.2012, AKKP-ja i është përgjigjur Ministrit të Drejtësisë se nga verifikimet pranë këtij institucioni rezulton se kërkuesja nuk ka aplikuar për kompensim financiar dhe, në këto kushte, ky institucion nuk mund të shprehet me vendim për pronën e pretenduar. Po ashtu, AKKP-ja e orienton kërkuesen që të aplikojë pranë këtij institucioni nga data 30.11.2012 deri në datën 28.12.2012, në përputhje me procedurat e përcaktuara në VKM-në nr. 768, datë 7.11.2011 "Për përcaktimin e rregullave dhe të kritereve për shpërndarjen e fondit të kompensimit pronarëve, në të holla, për vitin 2012".

11. Me kërkesën e datës 17.1.2013, kërkuesja i është drejtuar përsëri Ministrit të Drejtësisë, me kërkesë me të njëjtin objekt si më sipër.

II

12. Me kërkesën e datës 20.3.2013, ***kërkuesja Minerva Kotherja*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ajo pretendon se, pavarësisht detyrimit që lindte nga vendimi gjyqësor dhe qëndrimit të Ministrit të Drejtësisë për marrjen e masave përkatëse, AKKP-ja është përgjigjur se kërkuesja më parë duhej të aplikonte për kompensimin dhe se ajo nuk mund të shprehej me vendim. Në këtë mënyrë, AKKP-ja Tiranë, nëpërmjet sjelljes së saj, ka cenuar të drejtën e kërkueses për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

13. ***Subjektet e interesuara, AKKP-ja Tiranë dhe Ministria e Drejtësisë***, në parashtrimet drejtuar Gjykatës shprehen se:

13.1 AKKP-ja e ushtron veprimtarinë në zbatim të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës, i cili parashikon edhe rregullimin me akte nënligjore nga Këshilli i Ministrave, të procedurave, rregullave dhe kritereve që ajo duhet të zbatojë për shpërndarjen e fondit të kompensimit në të holla. AKKP-ja ka në kompetencën e saj njohjen e të drejtës së pronësisë dhe dhënien e vendimit për kthimin e pronës ose kompensimin e saj, si dhe vlerësimin e masës së kompensimit, por ajo nuk ka në kompetencë të vendosë pagesën e kompensimit pa një vendim të Këshillit të Ministrave.

13.2 Kërkueses nuk i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në kushtet kur konstatohet se ajo vetë nuk ka respektuar procedurat e kërkuara nga ligji dhe aktet nënligjore në fuqi, për të vënë në lëvizje procedimin administrativ. Nga verifikimet e kryera pranë AKKP-së, rezulton se kërkuesja nuk ka paraqitur asnjë kërkesë brenda afateve të përcaktuara me VKM për vitin kalendarik respektiv.

13.3 Kërkuesja keqinterpreton dispozitivin e vendimit të formës së prerë të gjykatës, i cili nuk shprehet për detyrimin e AKKP-së për të bërë pagesën e kompensimit, por për nxjerrjen e aktit lidhur me kërkesën për kompensim.

13.4 E drejta për një proces të rregullt duhet të konkurrojë me parimin e barazisë së shtetasve, në këtë rast. Organi administrativ e realizon këtë procedurë për të gjitha subjektet e shpronësuara, përfaqësuesit e tyre, konform të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në të njëjtën mënyrë dhe

sipas të njëjtave kushte.

13.5 Bazuar në vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në çështjen "Manushaqe Puto etj. kundër Shqipërisë", datë 31 korrik 2012, qeveria ka marrë të gjitha masat dhe po punon për hartimin e "Strategjisë kombëtare për pronën". Aktualisht, me VKM-në nr. 350, datë 29.4.2011, qeveria ka miratuar një plan të posaçëm veprimi për zgjidhjen e kësaj problematike.

III

**Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese**

A. *Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm*

14. Kërkuesja pretendon cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit nr. 1340, datë 24.2.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka vendosur detyrimin e AKKP-së për të nxjerrë aktin administrativ lidhur me kompensimin në vlerë të pronës së kërkueses.

15. Gjykata, në jurisprudencë konstante, ka theksuar se ekzekutimi, brenda një afati të arsyeshëm, i një vendimi të formës së prerë të gjykatës, është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së. Ai konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht dhe vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij kundrejt kreditorit. Në raste të tilla, procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave për rastin konkret, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Gjykata ka theksuar se, pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 2, datë 1.2.2011; nr. 1, datë 20.1.2012; nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 20, datë 29.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, të sanksionuara në nenin 42/2 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 56, datë 21.12.2012, nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 20, datë 29.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, dhe bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së, në vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve merr në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 10, datë 1.3.2012; nr. 49, datë 26.7.2012; nr. 56, datë 21.12.2012; nr. 20, datë 29.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe në çështjen konkrete në shqyrtim, vlerësimi për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor duhet të bëhet duke analizuar secilin nga elementet e mësipërme.

18. Lidhur me kompleksitetin e çështjes, për vlerësimin e tij duhet të merren parasysh të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e saj, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme *(shih vendimet nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 50, datë 22.11.2011*; *nr. 7, datë 27.2.2012; nr. 20, datë 29.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke iu referuar çështjes konkrete në shqyrtim, e cila ka për objekt mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor për nxjerrjen e aktit administrativ nga ana e AKKP-së për kompensimin në vlerë të

kërkueses, Gjykata vlerëson se ajo nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore, çka mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të AKKP-së.

19. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuesit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 50 datë 22.11.2011; nr. 20, datë 29.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga aktet e kësaj çështjeje rezulton se, me kërkesën e datës 12.1.2009, kërkuesja i është drejtuar AKKP-së për të përfituar kompensimin financiar për pronën, por kjo e fundit është përgjigjur se kërkuesja duhet të aplikojë pas publikimit të afatit kohor për aplikim për vitin pasardhës, pasi afati për paraqitjen e kërkesave kishte përfunduar tashmë në datën 3.12.2008. Kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi, me objekt detyrimin e AKKP-së të nxjerrë aktin administrativ përkatës për kompensimin në vlerë të pronës së saj. Pas dhënies së vendimit nr. 1340, datë 24.2.2011, nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i lënë në fuqi nga gjykata e apelit, kërkuesja i është drejtuar AKKP-së për ekzekutimin vullnetar të tij. Kërkuesja i është drejtuar edhe Ministrit të Drejtësisë në mënyrë që të ushtrojë kompetencat ligjore, të parashikuara në ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës, për ekzekutimin nga ana e AKKP-së të detyrimit që buron nga vendimi gjyqësor. Me shkresën nr. 4101/1 prot., datë 27.12.2012, drejtuar Ministrit të Drejtësisë, AKKP-ja parashtron se nga verifikimet e kryera pranë këtij institucioni rezulton se kërkuesja nuk ka aplikuar për kompensim financiar dhe, në këto kushte, ky institucion nuk mund të shprehet me vendim për pronën e pretenduar. Po ashtu, ajo orienton subjektin të aplikojë pranë AKKP-së nga data 30.11.2012 deri në datën 28.12.2012, në përputhje me procedurat e përcaktuara në VKM-në nr. 768, datë 7.11.2011 "Për përcaktimin e rregullave dhe të kritereve për shpërndarjen e fondit të kompensimit pronarëve, në të holla, për vitin 2012". Por edhe pas përgjigjes së AKKP-së dhe miratimit të VKM-së përkatëse për kriteret e shpërndarjes së fondit të kompensimit, kërkuesja nuk ka aplikuar pranë këtij organi për fillimin e procedurës së kompensimit në vlerë të pronës së saj, por ka vijuar të kërkojë ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

20. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka theksuar se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëlloj (*shih vendimet nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 7, datë 27.2.2012; nr. 56, datë 21.12.2012; nr. 20, datë 29.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese).*

21. Çështja në shqyrtim ka të bëjë me detyrimin e AKKP-së për të nxjerrë aktin administrativ për kërkesën për kompensim të kërkueses Minerva Kotherja, në zbatim të vendimit nr. 1340, datë 24. 2.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata vëren se, bazuar në nenin 11/d të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", për pronat e përcaktuara në këtë ligj, për të cilat është i pamundur kthimi fizik, shteti kompenson subjektet e shpronësuara me të holla, kurse, bazuar në nenin 15 të po këtij ligji, kompetenca për pranimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për kompensim i përket AKKP-së. Për qëllim të zbatimit të kompensimit financiar, me ligjin nr. 10239, datë 25.2.2010 "Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave", është përcaktuar fondi i kompensimit të pronave, i cili përdoret për kompensimin në vlerë të subjekteve të shpronësuara, të cilave u është njohur e drejta e kompensimit, kur kthimi fizik i pronës së tyre ka qenë i pamundur, fond, i cili po ashtu administrohet nga AKKP-ja. Bazuar në këtë ligj, subjektet e shpronësuara, të cilave u është njohur e drejta për kompensim, në përputhje me ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", përfitojnë kompensim nga fondi i kompensimit në masën dhe sipas mënyrës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, i cili në bazë të të ardhurave të arkëtuara, miraton shumën në dispozicion të pronarëve dhe shtrirjen kohore të përfitimit të kësaj shume. Gjykata vëren se është Këshilli i Ministrave që përcakton shumën në dispozicion për kompensimin e ish-pronarëve, skemën e kompensimit, si dhe dokumentet që duhet të paraqiten nga subjektet. Vetëm pas paraqitjes së kërkesës nga subjektet e interesuara, brenda afateve të përcaktuara, AKKP-ja investohet me shqyrtimin e dokumentacionit dhe, pas verifikimeve që kryen, merr vendimin për pranimin apo refuzimin e kësaj kërkese. Në qëndrimet e mbajtura nga AKKP-ja, lidhur me kërkuesen Minerva Kotherja, nuk rezulton që ky organ të ketë refuzuar dhënien e kompensimit ndaj saj, por ka kërkuar që kërkuesja të respektojë procedurën ligjore dhe të paraqesë kërkesë për kompensim brenda afateve të shpallura publikisht për këtë qëllim. Ndërkohë, kërkuesja Minerva Kotherja, pasi i është drejtuar AKKP-së me kërkesën e datës 12.1.2009, ka iniciuar procesin gjyqësor dhe në vijim nuk ka paraqitur më kërkesë pranë këtij organi,

edhe pas miratimit të VKM-së nr. 768, datë 7.11.2011 “Për përcaktimin e rregullave dhe të kritereve për shpërndarjen e fondit të kompensimit pronarëve, në të holla, për vitin 2012”.

22. Gjykata vëren se kërkuesja, pas dhënies së vendimit gjyqësor të cilin ajo kërkon që të ekzekutohet, ka pasur mundësinë që të aplikojë pranë AKKP-së në afatet dhe kushtet e përcaktuara për këtë qëllim nga Këshilli i Ministrave, gjë të cilën nuk rezulton ta ketë bërë. Për më tepër, detyrimi i AKKP-së për të nxjerrë aktin administrativ, në zbatim të vendimit nr. 1340, datë 24.2.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përbën një aspekt formal të procesit dhe jo një vendim përfundimtar që lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për kompensimin e pronës. Rrjedhimisht, mosnxjerrja e aktit administrativ nga AKKP-ja nuk e pengon kërkuesen të realizojë të drejtën materiale të kompensimit të pronës, nëpërmjet aplikimit dhe plotësimit të dokumentacionit përkatës të parashikuar nga kuadri ligjor në fuqi.

23. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se është vetë kërkuesja që me sjelljen dhe veprimet e saj ka shkaktuar vonesa në realizimin e të drejtës së saj, ndaj pretendimi për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 1340, datë 24.2.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk është i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të dalim me mendim pakice.

Nëpërmjet arsyetimit të saj, shumica ka konkluduar se është vetë kërkuesja që me sjelljen dhe veprimet e saj ka shkaktuar vonesa në realizimin e së drejtës së saj, ndaj pretendimi për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 1340, datë 24.2.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk është i bazuar (*shih prg. 23 të vendimit*).

Në çështjen në shqyrtim, kërkuesja, në thelb, kërkon të realizojë të drejtën materiale të kompensimit të pronës dhe i është drejtuar gjykatës në funksion të realizimit të kësaj të drejte. Ndryshe nga shumica, mendojmë se sjellja e kërkueses nuk ka shkaktuar vonesa në realizimin e së drejtës për kompensim të pronës dhe nuk ka penguar ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, i cili është marrë pikërisht për vendosjen në vend të së drejtës së kompensimit. Në referencë të qëndrimit të pakicës, të shprehur edhe në vendimin nr. 20, datë 29.4.2013, konstatojmë se megjithëse VKM-ja për miratimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit të pronarëve në të holla (VKM nr. 487, datë 6.5.2009) nuk ishte miratuar në momentin kur kërkuesja ka paraqitur kërkesën pranë AKKP-së (12.1.2009), kjo e fundit kishte mundësi të realizonte të drejtën e kompensimit në bazë të kuadrit ligjor në

fuqi, përkatësisht, ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", *të ndryshuar*[1], dhe VKM-së nr. 139, datë 13.2.2008, që përcaktonte hartën e vlerës së trojeve dhe çmimet përkatëse. Sipas nenit 16 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, *të ndryshuar*, zyra e AKKP-së bën shqyrtimin fillestar të kërkesës së subjektit të shpronësuar për kompensim dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, në zbatim të përgjegjësive të veta për kompensimin, shprehet me vendim. Vendimi duhet të jetë në formë të shkruar, të arsyetuar, të nënshkruar nga titullari dhe të përmbushë kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative (KPA) për aktin administrativ. AKKP-ja, në rastin konkret, nuk është shprehur me vendim por i ka kthyer përgjigje kërkueses, duke i kërkuar të aplikojë për kompensim pas njoftimit të datës për aplikim (*shih prg. 3 të vendimit*), datë e cila do të përcaktohej në një akt nënligjor (VKM) që ende nuk ishte nxjerrë nga Këshilli i Ministrave. Kjo përgjigje e AKKP-së është e paqartë dhe nuk i plotëson garancitë dhe parashikueshmërinë në zbatimin e së drejtës dhe sistemit normativ që kërkon parimi i sigurisë juridike. Procesi i kthimit dhe kompensimit duhet të krijojë përshtypjen te subjektet e së drejtës se institucionet përgjegjëse do t'u përmbahen normave juridike në fuqi duke garantuar, me vendimmarrjen e tyre, siguri dhe qëndrueshmëri për të ardhmen. Pasoja e parashikueshme për kërkuesin, i cili është subjekt i ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës në dispozita të veçanta të tij, është marrja e vendimit, sipas ligjit, nga ana e AKKP-së, gjë të cilën kjo e fundit nuk e ka bërë. Ndaj, ndryshe nga shumica, çmojmë se AKKP-ja, e cila ka rolin kryesor në këtë proces, duke mos nxjerrë aktin administrativ përkatës, në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë, ka penguar realizimin e së drejtës për kompensim të kërkueses.

Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, në kuptim të nenit 13 të Konventës, mjetet në dispozicion të një ndërgjyqësi *për të parashtruar një ankesë për zgjatjen e procesit* janë "efektive", në qoftë se ato "parandalojnë shkeljen e pretenduar apo pengojnë vazhdimin e saj, apo ofrojnë një riparim të përshtatshëm për çdo shkelje që tashmë ka ndodhur" (*shih Gjyli kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, prg. 53; Scordino kundër Italisë, nr. 1, datë 29.3.2006, prg. 183, 186).* Megjithatë, kur një vendim përfundimtar është dhënë në favor të një individi, ndaj shtetit, individi nuk duhet, si rregull, të jetë i detyruar të hapë procedurë të veçantë për zbatimin e vendimit (*shih Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 17.12.2012, prg. 71*; *Metaxas kundër Greqisë, datë 27.5.2004*).

Në çështjen në shqyrtim, nga aktet shkresore, del qartë se kërkuesja i ka përmbushur të gjitha detyrimet procedurale që i takonin asaj dhe i ka ezauruar të gjitha mjetet ligjore që legjislacioni shqiptar i ka vënë në dispozicion. Ajo nuk disponon mjet tjetër efektiv për të realizuar të drejtën e kompensimit, duke pasur parasysh se sistemi juridik shqiptar nuk parashikon ndonjë mjet juridik të veçantë për të përshpejtuar procesin e kompensimit të pronës, me qëllim parandalimin e tejzgjatjes dhe zvarritjes së tij, dhe as për kompensimin e vonesave, që do të riparonte shkeljet *a posteriori.*

Duke pasur parasysh standardet e mësipërme të vendosura nga GJEDNJ-ja, si dhe në vështrim të fakteve të çështjes konkrete, vlerësojmë se mosekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë, në kushtet e mospasjes së një mjeti tjetër efektiv, e ka penguar kërkuesen të realizojë të drejtën materiale të kompensimit të pronës. Për pasojë, Gjykata duhet të kishte vendosur pranimin e kërkesës dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

Anëtarë: Fatmir Hoxha, Sokol Berberi

[1] Ndryshuar me ligjin nr. 9583, datë 17.7.2006 dhe ligjin nr. 9898, datë 10.4.2008.